

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 24.04.2013

Nr. 0204 - 463

PËR: Shaip Surdulli, Kryetar i Komunës së Kamenicës
Enver Mavriqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË KAMENICËS, 01 Nr. 3672, Pranuar me datë, 10.04.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 3672, të miratuar me datë 29.03.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr. 3672 për plotësimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale me një anëtar nga komunitetet jo shumicë.

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 24.04.2013
br. 0204 - 463

Za: Shaip Surdulli, Gradonačelnik opštine Kamenica
Enver Mavriqi, Predsedavajući Skupštine opštine Kamenica

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Kamenica, 01 br. 3672, primljeno dana
, 10.04.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim adminstativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01 br. 3672, odobreno dana 29.03.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01 br. 3672 o dopuni komisije za izbor lokalnih saveta za jednim članom nevećinske zajednice .

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



KOMUNA E KAMENICËS
KUVENDI I KOMUNËS

01.Nr. _____, Më 29.03.2013



Në bazë të dispozitave të nenit 58 (Ligji nr.11) dhe 43 të LVL-së (Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale) Ligji nr.03/L-040, nenit 4 të Rregullores 01 nr.5185/06.11.2012 të Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Kamenicës si dhe nenit 52, 53, 54, dhe 55 të Statutit të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2013 mori

VENDIM

PËR PLOTËSIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE ME NJË ANËTAR NGA KOMUNITETET JO SHUMICË

I

Plotësohet Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale me një anëtar nga radhët e komuniteteve jo shumicë dhe ate me Dejan Blagojeviqin nga Kamenica. I njëjti obligohet që të ndihmojë në organizimin dhe zgjedhjen e këshillave lokale në lokalitet me popullatë të përzier dhe në lokalitetet me popullatë serbe. Mbeten në fuqi dispozitat tjera të Vendimit për formimin e këshillave lokale nga data 30.01.2013.

1. Samir Kryeziu, kryetar
2. Qemajl Beqiri, anëtar
3. Fisnik Kastrati, anëtar dhe
4. Dejan Blagojeviq.

II

Komisioni në tërësi duhet të veprtoj në përputhje me Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Kamenicës, ligjeve në fuqi dhe akteve tjera që përcaktojnë procedurën zgjedhore.

Është përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Komisioni dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.

Komisioni nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes: shpalljeve

publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhen këshillat lokale; mediave lokale dhe wfluqes zyrtare të komunës.

Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë: rendin e ditës; datën; kohën; dhe vendin e mbajtjes së tubimit.

III

Implementimin e vendimit e bën komisioni, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset kryetari i komunës.

IV

Me vendimin të njoftohen: Kryetari, kryesuesi, anëtarët e komisionit, zyra ligjore, zyra e përkthimeve, Shërbimi profesional i kuvendit dhe Qendra për shërbime të qytetarëve.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Enver Mavriqi
Enver Mavriqi